

RAPORTI I SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT TË KOMUNITETIT LGBT 2011

JANAR 2011

⇒ Rasti i *Kleas*

Klea, pjesëtare e komunitetit transgjnor, raportoi pranë Ambasadës PINK, më 12 Janar Tiranë që ishte helmuar dhe shkoi në spital, ku ndeshi diskriminim për shkak të identitetit të saj gjnor. Në fillim asaj nuk iu ofrua asnjë shërbim, dhe e lanë të priste për 45 minuta dhe pasi një doktor dhe roje spitali e takuan, e ofenduan dhe diskriminuan për shkak të identitetit të saj gjnor. Ambasada PINK reagoi duke dërguar një letër ankese pranë Komisioneres kundër Diskriminimit, ku kërkohet hetim të plotë të çështjes dhe marrjen e masave përkatëse, sepse kemi të bëjmë me një shkelje të të drejtave të njeriut dhe një rast të pastër diskriminimi. Por çështja nuk u ndoq deri në fund, pasi Klea refuzoi ta bënte këtë çështje publike.

SHKURT 2011

⇒ Rasti i *Anxhelës*

Anxhela, pjesëtare e komunitetit të transgjnorëve, raportoi pranë Ambasadës PINK, më 22 Shkurt, Tiranë dhunën e vazhdueshme që komuniteti transgjnor vuan nga grupe të rinjsh apo klientë (shumica e transgjnorëve me të cilët kemi kontakt janë punonjëse seksi) dhe indiferencën dhe vonesat që vuajnë nga forcat e rendit për denoncimet e rasteve të tyre. Ambasada PINK reagoi duke dërguar një letër ankese pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe informoi Drejtorin e Policisë dhe Komisioneren Kundër Diskriminimit për çështjen.

MARS 2011

⇒ Shkelen të drejtat e transgjnorëve

Gjatë muajit Mars, Ambasada PINK ka marrë një sërë ankesash nga komuniteti transgjnor për shkeljen e të drejtave të tyre. Më konkretisht më 1, 10, 15 dhe 24 Mars Ambasada PINK u takua dhe intervistoi individualisht 4 anëtare të këtij komuniteti: Anxhela, Brikena, Nikoleta and Lili (MTF). Të gjitha raportuan dhunën e pësuar nga të rinj, klientë dhe Policia. Ato raportuan se Policia po injoronte raportimet e tyre për tu mbrojtur nga aktet e dhunës. Ambasada PINK reagoi duke bërë një takim me Drejtorinë

e Policisë në Tiranë dhe u kërkoi që të përmirësonin sjelljen e tyre ndaj komunitetit transgjnor.

PRILL 2011

⇒ **Rasti i *Brikenës* dhe *Anxhelës***

Më 6 Prill, *Anxhela*, pjesëtare e komunitetit të transgjnorëve në Tiranë (MTF) u sulmua nga një person i paidentifikuar, pranë godinës së Operas, zonë ku transgjnorët ushtrojnë aktivitetin si punonjëse seksi; personi e goditi dhe e agresoi me thikë. Rasti u denoncua në Rajonin e Policisë Nr. 1 në Tiranë. Një dokument iu dërgua Drejtorit të Policisë në mënyrë që Ambasada PINK mund të ndiqte procesin e hetimeve.

Më 8 Prill, *Brikena* pjesëtare e komunitetit të transgjnorëve në Tiranë (MTF) raportoi një rast diskriminimi nga policia kufitare greke në Kavajë/Gjirokastër. Më 5 Prill pasi kaloi kufirin shqiptar (vërtetuar nga vula në pashaportë), polici grek pyeti nëse ajo është gei. Përgjigja ishte, po. Dhe pas kësaj përgjigje nuk është lejuar të kaloi kufirin.

⇒ **Shtëpisë së transgjnorëve i vihet zjarri**

Më 27 Prill, shtëpisë ku 5 transgjnorë jetonin iu vu zjarri nga një person homo/trans fobik. Ambasada PINK reagoi menjëherë, me një njoftim për shtyp drejtuar medias dhe forcave të rendit për të identifikuar fajtorin. Pas këtij reagimi policia hetoi mbi rastin dhe identifikoi personin fajtor, që është në kërkim nga policia.

MAJ 2011

⇒ **Kërcënimi i *Anxhelës***

Më 5 maj *Anxhela*, pjesëtare e komunitetit të transgjnorëve, raportoi tek Ambasada PINK për personin që dogji shtëpinë. Ajo deklaroi se kishte marrë kërcënime nga personi në fjalë. Gjithashtu denoncoi kërcënimet tek rajoni Nr.3 i policisë në Tiranë. Personi që kërcënoi *Anxhelën* po hetohet në gjendje të lirë.

KORRIK 2011

⇒ ***Anxhela* dhunohet**

Më 20 korrik, *Anxhela*, pjesëtare e komunitetit të transgjnorëve në Tiranë, (MTF) raportoi se një ditë më parë ishte rrahur dhe ofenduar nga një klient. Ajo kishte folur me Policinë, që kishte shoqëruar agresorin në Komisariatit Nr.1, ndërkohë *Anxhela* ishte dërguar në spital ku mori ndihmën e parë.

GUSHT 2011

⇒ Dhunimi i Palomës

Më 14 Korrik, Paloma pjesëtare e komunitetit të transgjnorëve në Tiranë (MTF), raportoi te Ambasada PINK dhunën e pësuar nga 6 oficerë të Policisë së Shtetit. Gjatë një hetimi, kishin ndaluar për një investigim partnerin e Palomës, e cila i kishte rezistuar këtij veprimi. Në një farë pike ajo goditi oficeren grua që ishte në vendngjarje. Kjo u pasua nga një reagim i pajustificuar i 6 oficerëve të Policisë të cilët agresuan Palomën dhe vazhduan ta rrihnin dhe kur e dërguan tek Komisariati Nr.1. Pas orësh dhune, Paloma e mbuluar në gjak i kishte rënë të fikët. Ambasada PINK dërgoi ankesë zyrtare tek Ministria e Punëve të Brendshme dhe tek Avokati i Popullit, që të fillonin hetimet e rastit, ndërkohë që publikoi një njoftim për shtyp.

SHTATOR 2011

⇒ Dhunimi i Anxhelës

Më 30 Shtator, Anxhela, pjesëtare e komunitetit të transgjnorëve në Tiranë (MTF), raportoi dhunën e pësuar nga oficerët e policisë të cilët e kishin ndaluar teksa ushtronte aktivitetin si punonjëse seksi. Dhuna vazhdoi dhe në komisariat kur ajo po merrej në pyetje si autore e një vjedhjeje. Arsyeja e vetme pse po hetohej ishte se është transgjnore, dhe policia argumentonte se “këta njerëz janë hajdutë, të cilët ditët vishen si burra e natën si gra”. Pasi Anxhela deklaroi se nuk kishte të bënte me vjedhjen u lirua. Për shkak të dhunës së policisë, Anxhela dërgoi një ankesë tek Avokati i Popullit, e asistuar nga Ambasada PINK.

TETOR 2011

⇒ Diskriminimi i çiftit gay

Një çift gay në Tiranë, raportoi në Ambasadën PINK dhunën dhe diskriminimin që kishin pësuar nga policia dhe të afërmit. Pas një incidenti familjar lidhur me faktin që ishin gei dhe që bashkëjetonin, në rastin që njëri nga vëllezërit e djemve kishte agresuar dhe kërcënuar t’i vriste, çifti kishte shkuar në Polici për denoncim. Sapo shpjeguan situatën ata ishin pritur me të qeshura dhe ofendime nga oficerët e Policisë. Në vend që të merrnin denoncimin dhe të merrnin masat e duhura, Policia e mbajti çiftin dhe për 10 orë të tjera, duke i trajtuar si fajtor të incidentit. Gjatë gjithë kohës që ishin në rajon janë tallur dhe ofenduar për shkak të orientimit të tyre seksual. Pas marrjes së incidentit të tyre Ambasada PINK dërgoi një letër ankese Komisioneres së Diskriminimit dhe asistoi çiftin në përgatitjen e dokumentacioneve. Ndërkohë Ambasada PINK e referoi rastin tek seksioni për dhunën në familje në Bashkinë e Tiranës, dhe u kërkoi të hetonin për oficerës përgjegjës. Ambasada PINK negocioi për ndihmë ligjore falas për rastin nga një studio ligjore në Tiranë.

⇒ **Diegja e rrobave të Anxhelës**

Më 24 tetor, Anxhela, pjesëtare e komunitetit të transgjinjorëve në Tiranë (MTF), raportoi diegjen e rrobave të saj pranë vendit ku banon. Ajo dyshon që diegja e rrobave ka ndodhur për shkak të identitetit të saj gjinor. Në të njëjtën ditë ajo shkoi pranë Komisarariatit Nr.1, ku nuk u pranua me pretekstin se nuk ndodhej shefi i zyrës.

NËNTOR 2011

⇒ **Çështja Shehu**

Më 4 Nëntor Ambasada PINK dërgoi një ankesë zyrtare pranë Komisioneres kundër Diskriminimit, për diskriminimin e komunitetit në media ndodhur më 28, dhe 20 tetor, nga parlamentari Tritan Shehu. Ai kishte quajtur në publik homoseksualitetin si një devijim nga norma. Çështja po ndiqet nga Komisionerja Kundër Diskriminimit.

⇒ **Rasti Perla**

Më 8 Nëntor, Perla, pjesëtar i komunitetit LGBT, erdhi në Ambasadën PINK, për të raportuar një dhunim të të drejtave të privatësise nga një organizatë. Më specifikisht Perla kishte dhënë një intervistë për orientimin e tij seksual dhe jetën e tij seksuale, kësaj organizate. Ky informacion dy vite mbasi ishte dhënë nga Perla, kishte mbërritur në duart e të vëllait. Që nga kjo pjesë jeta e tij është bërë shumë e vështirë. Kërkoj për mbështetjen tonë, në rast se marrëdhëniet me familjen do përkeqsoheshin. Ambasada PINK asistoi Perlën dhe organizoi një takim mes tij dhe organizatës në fjalë. Perla ende nuk ka vendosur për masat e mara.